

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Cindy Crawford përjetoi vite të vështira për djalin e saj? Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/cindy-crawford-perjetoi-vite-te-veshtira-per-djalin-e-saj/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 22:06:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 21:57:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7c12531bf160e11d902b4842bea7a95c187bbd759d154321f30c87889427458e
TEKSTI	6507412f71dbd0349007c6c91dbae3b4f40d52de297ee4bfe7b728ad1169c3df
PAMJA	cbcf8652773285a426c71d4bcdba352a052e5fc4acd02567d2279a70ae1a66fc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86c692f24e9533773b05bd431052afc7de09310be106bafdc74257d79970c9ea
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1dbf354c1d8a7e10676d5dc807041131f6f91b350312b5ba1dad36679b44d28c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/86c692f24e9533773b05bd431052afc7de09310be106bafdc74257d79970c9ea>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Cindy Crawford përjetoi vite të vështira për djalin e saj?



Redaksia K

25 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Familja e supermodeles Cindy Crawford po përballet me një humbje të rëndë pas vdekjes së djalit të saj, **Presley Gerber**, në moshën 27-vjeçare.

Presley, djali i vetëm i Crawford dhe biznesmenit Rande Gerber, ndërroi jetë më 20 shtator në një qendër rehabilitimi në Kaliforni. Autoritetet kanë nisur hetimet për vdekjen e tij, ndërsa shkaku përfundimtar ende nuk është përcaktuar. Policia po e heton rastin si një mbidozë të dyshuar, ndërsa deri tani nuk ka indikacione për ndonjë veprim kriminal.

Pas vdekjes së tij, janë rikthyer në vëmendje edhe rrëfimet e familjes për betejën shumëvjeçare të Presley me varësinë dhe problemet e shëndetit mendor.

Sipas motrës së tij, Kaia Gerber, Presley kishte luftuar me varësinë për rreth një dekadë dhe familja kishte kaluar vite duke kërkuar mënyra për ta ndihmuar.

Në një intervistë të dhënë për "Vogue" vetëm pak javë para vdekjes së tij, Kaia foli për ndikimin që kjo situatë kishte pasur tek të gjithë familjarët.



Kur diçka e tillë ndodh në një familje, disi i vendos të gjithë në të njëjtin nivel

-kishte thënë Kaia.

Ajo kishte treguar gjithashtu se prindërit e saj kishin qenë gjithmonë shumë privatë për çështjet familjare, ndërsa Presley kishte zgjedhur një qasje krejt tjetër, duke folur hapur për vështirësitë e tij.



Tani kemi këtë mësues absolut, vëllain tim, i cili thotë: 'Do të jem shumë njerëzor për të gjithë'

-ishite shprehur Kaia.

Presley nuk e kishte fshehur publikisht betejën e tij. Në rrjetet sociale ai kishte folur për depresionin, përdorimin e substancave dhe përpjekjet e vazhdueshme për të gjetur trajtimin që do ta ndihmonte.

Në mars të këtij viti, ai publikoi një video nga Meksika, ku tregonte se po përgatitej t'i nënshtrohej një trajtimi me ibogainë, një substancë psikoaktive që është studiuar për potencialin e saj në trajtimin e varësisë.



Po lutem që kjo të jetë hera e fundit që duhet të kthehem

-kishte shkruar ai në atë kohë.

Cindy Crawford e kishte mbështetur publikisht djalin e saj, duke komentuar në postimin e tij:



Je një luftëtar! Ke kaluar përmes zjarrit për të gjetur veten! Jam shumë krenare!

Edhe babai i tij, Rande Gerber, i kishte shprehur mbështetjen, duke shkruar se ishte krenar për guximin e të birit dhe për përpjekjet e tij për të gjetur rrugën drejt rikuperimit.

Në një video të publikuar në fund të vitit 2025, **Presley** kishte folur për përdorimin e disa medikamenteve dhe për vështirësitë që kishte hasur gjatë trajtimeve.

Ai kishte treguar se kishte konsultuar rreth 15 psikiatër dhe se kishte marrë këshilla të ndryshme për trajtimin e tij.



Kam pasur shumë humbje, në forma të ndryshme, kohët e fundit

-kishte thënë ai.

Presley kishte nisur gjithashtu një seri të quajtur "Mental Health Mondays", përmes së cilës fliste për përvojat e tij dhe përpjekjet të nxiste biseda më të hapura rreth shëndetit mendor dhe varësisë.

Presley ishte model që në adoleshencë dhe kishte punuar për marka të njohura si Calvin Klein dhe Dolce & Gabbana. Ai kishte ndërtuar një karrierë të tijën në modë, pavarësisht se ishte djali i një prej supermodeleve më të njohura të botës.

Vdekja e tij ka tronditur familjen, e cila përmes një përfaqësuesi ka kërkuar që privatësia e tyre të respektohet gjatë kësaj periudhe.



Familja po kërkon privatësi gjatë kësaj kohe shumë të vështirë dhe të dhimbshme

-është bërë e ditur në emër të familjes.

Ndërkohë, hetimi për rrethanat e vdekjes së Presley Gerber vazhdon. Autoritetet kanë kryer autopsinë, por rezultatet përfundimtare dhe shkaku zyrtar i vdekjes pritet të përcaktohen pas analizave të mëtejshme.

LAJME TË NGJASHME



Vdekja e Presley Gerber merr një kthesë të re? Mjeku dyshohet se i përshkroi ketaminë?

2 MIN



“Ti meritoje më shumë...” Ish-e dashura e Presley Gerber shpërthen në dhimbje!

2 MIN




Vdekja e Presley Gerber po hetohet si mbidozë e dyshuar?

2 MIN



Presley Gerber foli hapur për varësinë para vdekjes!
“Isha absolutisht i tmerruar”

3.5 MIN



“Jam plotësisht e zemërt”/ Paris Hilton reagon pas vdekjes së Presley Gerber!

2 MIN

MË TË LEXUARAT



Arrestohet Susan Sarandon/Protestoi kundër Netanyahu-t në OKB!



Lonely Planet zbulon destinacionet më të mira për 2027-ën!



Nations League, Kosova debuton me fitore!




Italia ndalon burkën në shkolla/Kufizime edhe për nxënësit e huaj në klasa!



Parada Seksi e Yjeve: kush do të digjet nga dashuria këtë fundjavë!



Si i jep fund marrëdhënieve secila shenjë e zodiakut!



55-vjeçarit i nxjerrin nga barku ngjalën e gjallë pas një dite!



Në këtë vend mendojeni dy herë para se të dëgjoni muzikë me zë të lartë, do të gjobiteni!





Agim Ademi, mesazh emocionues pas fitores së “Dardanëve”!



Rama në Këshillin Europian të Korporatave: Paqja, kusht për zhvillimin ekonomik!

EDITORI SUGJERON





Sa kalori digjen gjatë vërtetë seksit?!



Melatonina apo L-Theanine?! Ja cili suplement mund të ndihmojë më shumë me gjumin...



Një ilaç i ri për kancerin e pankreasit mund t'u japë pacientëve më shumë kohë!




"Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe..." / Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?



A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballet me tundimet seksuale: Edhe tani me vajza të bukura...



"Me bezdis përndjekja..." / Ina Aderi: Më kanë ngacmuar personazhe, do dashurohem larg kamerave...




Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...



Mund t'u mungosh shumë, por mesazhin mos e prit! 3 shenjat e horoskopit që nuk bëjnë kurrë hapin e parë...



Fenomeni "pocketing"/ Kur partneri të mban sekret dhe askush në jetën e tij nuk e di që ekziston...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania

Email:

Tel: +355 69 208 0500

+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktoni
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.